



Prishtinë: 29.03.2018

Kodi i ZRRE-së: V_963_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1623_09_17**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **04.10.2017**.

në seancën e mbajtur më datë 29.03.2018, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit N.B., nga Fshati Baks, Skenderaj me shifër **DMI – 9030782** si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1623_09_17** i datës 14.09.2017.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 03.11.2017 ka pranuar ankesën e parashtruar nga konsumatori N.B., i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se kundërshton ngarkesën prej 80€ për shkak të një faze të njehsorit që nuk ka regjistruar saktë. Konsumatori në ankesë ka theksuar se sipas procesverbalit të kalibrimit është konstatuar se njehsori nga ana e jashtme është në gjendje të rregullt, ndërsa për shkak të zbrazjes atmosferike ka ardhur deri te dëmtimi i fazës dhe se konsumatori ka theksuar se ka pasur edhe dëme edhe në pajisje tjera, dhe se KEDS pas këtij defekti kanë bërë urëzimin dhe se janë shfrytëzu vetëm dy faza. Gjithashtu konsumatori ka theksuar se sipas vendimit të shkallës së parë se njehsori paraparak dhe ai aktual janë pothuajse të njëjtë, këtë e konsideroj si provë në favor të konsumatorit dhe se pse dy vite diferencë shpenzimi mund të rritet për shkak të pajisjeve.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve, dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i ZRRE-së, ka analizuar dhe shqyrtuar me kujdes të gjitha pretendimet ankimore të konsumatorit të theksuara në ankesë, por që nuk ka vërtetuar me asnjë element se konsumatori



është i dëmtuar dhe ngarkuar me ndonjë vlerë financiare më tepër se sa shpenzimi i energjisë elektrike të bërë në këtë pikë matëse.

Bordi ka analizuar të gjitha konstatimet e theksuara nga shkalla e parë lidhur me gjendjen e shpenzimit të energjisë elektrike dhe me këtë ka vërtetuar se, pas ndërrimit të njehsorit elektrik ku është larguar nga matja njehsori elektrik nr.32263884 dhe është vendosur për matje njehsori elektrik nr. 64639660 , njehsori i demontuar nr.32263884 është dërguar në qendrën e kalibrimit për verifikim dhe se nga punëtorët e qendrës së kalibrimit është konstatuar se njehsori elektrik bllobat (vulat) i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori elektrik dëmtime nuk ka kurse në brendi të njehsorit është vërejtur se sistemi i fazës R është i djegur dhe si pasojë njehsori elektrik ka regjistruar energji elektrike 33.33% më pak.

Bordi ka analizuar edhe pikën tjetër të kundërshtimit rreth shpenzimeve të energjisë elektrike dhe thekson se organi i shkallës së parë ka bërë analizimin e shpenzimit të energjisë elektrike të dy njehsorëve në periudha të ndryshme dhe se sipas rrjedhës së energjisë elektrike mesatarja e shpenzimeve me njehsorin elektrik nr.32263884 për periudhën 04/2015 deri në periudhën 09/2015 është **463 kWh/muaj**, periudhën 04/2014 deri në periudhën 09/2014 është **478 kWh/muaj**, kurse me njehsorin elektrik nr.64639660 periudha 04/2016 deri në periudhën 09/2016 është **508 kWh/muaj**, si dhe periudha 04/2017 deri në periudhën 08/2016 është **507 kWh/muaj**, e që sipas paraqet një rritje të shpenzimit prej **9%**.

Sa i përket pikës tjetër të kundërshtimit rreth defektit të fazës, e cila sipas konsumatorit ka ardhur pas zbrazjes atmosferike, dhe se punëtorët e KEDS kenë ndërhy duke bërë ndërhyrje në kutin e siguresave me çka kemi vazhduar të furnizohemi me vetëm dy faza. Lidhur me këtë Bordi i ZRRE, ka konstatuar se organi i shkallës së parë ka vepruar drejtë kur ka kërkuar nga konsumatori të ofroj ndonjë dëshmi, por që konsumatori nuk ka arritur të ofroj asnjë provë me të cilën do të vërtetohej se ka njoftuar KEDS-in lidhur me defektin në njehsorin elektrik, andaj edhe ky argument nuk mund të vërtetohet.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i Rregullatorit:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit N. B. dhe
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së